

L I G J
Nr.8138, datë 31.7.1996

**PËR NJË PLOTËSIM NË LIGJIN NR.8068, DATË 15.2.1996 “PËR DISA NDRYSHIME NË
LIGJIN NR.7572, DATË 10.6.1992 “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
PUSHTETIT LOKAL”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 1 të ligjit 8068, datë 15.2.1996 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7572, datë 10.6.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, paragrafi i fundit, shtohet fraza:

“Në rast se këshilli i rrethit nuk arrin të zgjedhë kryetarin e ri brenda afatit të caktuar, Këshilli i Ministrave cakton një të deleguar të tij për të kryer funksionet e kryetarit të këshillit të rrethit.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi më 31 korrik 1996.

Shpallur me dekretin nr.1574, datë 2.8.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha